



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 3 korrik 2013

**Mbledhja e tretë shqyrtuese mbi seminarin e romëve u  
mbajt më 26 korrik 2011**

**Takim pune për përfshirjen e romëve dhe refugjatëve romë**

[Salla e Konferencave, ndërtesa e qeverisë]

Fjalim

Ambasadori Aivo Orav

Shef i Delegacionit të BE-së

**I nderuari Ministër, i nderuari Zëvendës Ministër,  
Ekselenca,  
Zonja dhe zotërinj**

Kam kënaqësinë të jem pjesë e Mbledhjes së sotshme të tretë shqyrtuese mbi seminarin e romëve që u mbajt në vitin 2011.

Kjo mbledhje ofron një mundësi të shkëlqyeshme për shqyrtimin gjithëpërfshirës të rekomandimeve politike dhe për të ndarë informatat lidhur me progresin e arritur.

Bashkimi Evropian është duke ndërmarrë një varg masash për përmirësimin e përfshirjes sociale dhe integrimin e romëve në shoqëri.

Në vendet e Ballkanit Perëndimor, Bashkimi Evropian në bashkëpunim me qeveritë, ka inicuar disa seminare nacionale mbi romët, të cilat kanë involvuar autoritetet nacionale dhe lokale, organizatat joqeveritare, donatorët dhe përfaqësuesit romë, duke futurë kështu një vegël të re në trajtimin e çështjeve rome.

Rekomandimet nga tre evenimentet paraprake janë pjesë e një Plani të Veprimit, i cili azhurnohet çdo gjashtë muaj dhe publikohet në ueb faqet e Ministrisë së Punës dhe Politikës

Sociale dhe Ministrit pa Resor - z. Mustafa. Të gjitha palët inkurajohen të japin komentet e tyre lidhur me Planin e Veprimit, në mënyrë që të kenë një dokument të përgjithshëm, i cili do të implementohet me sukses. Në këtë mënyrë, ne do të kemi ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e të gjithë individëve romë.

Ky eveniment është një mundësi unike për përfaqësuesit e Qeverisë, për të diskutuar hapur çështjet e romëve me komunitetin e donatorëve dhe përfaqësuesit e komunitetit rom. Duke marrë parasysh se Strategjia Rome është aktualisht nën rishqyrtim, do të ishte e dobishme nëse në Strategjinë e ardhshme përfshihet një format i ngjashëm i mbledhjeve të rregullta me diskutime të hapura dhe mënyrën e zhvillimit.

Bashkimi Evropian do të vazhdojë të mbikqyrë implementimin e Planit të Veprimit. Ky do të shërbejë gjithashtu edhe si një nga dokumentet themelore për të programuar ndihmën e ardhshme IPA. Statusi i romëve është gjithashtu pjesë e Raportit të rregullt të Progresit për vendin.

Më lejoni të konkludoj duke thënë se është i nevojshëm vullneti i fuqishëm politik dhe vendosmëria në të gjitha nivelet, në mënyrë që çështjet romë të trajtohen në mënyrë të suksesshme. Bashkëpunimi i përmirësuar mes institucioneve shtetërore dhe ndarja e duhur financiare janë gjithashtu të nevojshme.

Nga ana tjetër, ekziston nevoja për një ndjesi më të fuqishme të përgjegjësisë mes liderëve romë, të cilët duhet të përqëndrohen drejt përmirësimeve afatgjata strukturore.

Krahas fushave konkrete të politikës, ne inkurajojmë autoritetet t'u kushtojnë vëmendje të njëtrajtshme çështjeve siç janë koordinimi, vlerësimi, monitorimi, financimi dhe kapacitetet e institucioneve.

Ju uroj shumë sukses në arritjen e synimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit.

Ju felminderit për vëmendjen tuaj!